



**REPUBLIKA E KOSOVËS**

**KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI**

### **PROCESVERBAL**

#### **Nga mbledhja e V-të për vitin 2013, e Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 30.05.2013**

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 10:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Naile Osman, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muhamrem Shabani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtoret e drejtorive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapi debatin për rendin e ditës.

**Debat lidhur me rendin e ditës:**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** kërkoi informatë me shkrim lidhur me ecurinë dhe dinamikën e punimeve në fabrikën e ujit, si dhe kur përfundon. Pastaj në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që të sillet vendimi që taksa komunale vjetore të hiqet për bizneset. Mandej kërkoi që komuna të caktojë një datë për çdo muaj, për të organizuar aksione vullnetare për pastërtinë e ambientit, kurse në vazhdim tha se e ka marrë një peticion nga banorët e fshatit Nadakoc për rrënimin e objektit të vjetër shkollor, prandaj kërkoi nga kryetari i komunës që të ndërmerr masa për t'u kryer më shpejt, për të mos e humbur një donacion. Në fund pyeti se a është ndërrmar diçka lidhur me peticionin e banorëve të fshatit Stanoc, i cili ka të bëjë me objektin kontestimor.

**Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit-** në emër të një lagjeje të fshatit Maxhunaj kërkoi që të vendosen "polic të vdekur", pasi që janë shumë të rrezikuar nga vozitja e shpejt, prandaj pyeti se a do të ndërmerr diçka për çështjen në fjalë.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** i propozoi kuvendit të komunës shqyrtimin e propozimit për vendosjen e ndriçimit përreth Palestrës së Sporteve "Jeton Tërstena",

pasi që ka pas raste kur pas ndeshjeve sportive të rinjtë kanë hedhur gurë nga pjesa që ka qenë e errësuar. Po ashtu i propozoi kuvendit për të shqyrtuar marrjen e vendimit që në të gjitha institucionet arsimore dhe shëndetësore në Komunën e Vushtrrisë të vendoset një mbishkrim standard me logo të Republikës së Kosovës.

**Qazim Azemi**, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të AAK-së pyeti pse nuk është zgjidhur problemi i rrugës Pasomë-Sllatinë dhe shtoi se kompania "Rukolli" e cila është shfrytëzuese e zhavorit në atë fshat, është dashtë ta shtrojë në asfalt para katër vitesh, pasi që ekziston marrëveshja e komunës me këtë kompani për shtrimin e rrugës, prandaj kërkoi përgjigje me shkrim pse nuk është zbatuar kjo marrëveshje. Pastaj tha se pasi që kanë qenë të penguar nga punimet, është një kërkësë e bizneseve dhe zejtarëve në rrugën "Dëshmorët e Kombit" që ose t'i u zvogëlohet tatimi ose të lironen nga taksa për këta muaj sa janë penguar nga punimet, dhe njëkohësisht të njëjtat biznese kanë kërkuar që të gjendet një formë që të mos malfrotohen çdo vit për regjistrimin e atyre bizneseve, si dhe gjatë sezonit të verës orari i punës të jetë më i gjatë. Mandej pyeti për disa pagesa honorare për profesorët në dy shkollat e mesme profesionale dhe teknike, pasi që nuk janë paguar qe tri afate, që nga viti shkollor 2011-2012. Në vazhdim pyeti lidhur me çështjen e "Shtëpisë së Mallrave", pasi që ka hyrë në rrjedhën e privatizimit, me ç'rast tha se në çfarë rrjedha po shkon privatizimi i saj, pasi që është me interes kapital për komunën. Në fund tha se objekti i "Qendrës së Kulturës" është duke u rrezikuar në forma të ndryshme, pasi që është duke u gërmuar kanal përreth saj, prandaj kërkoi përgjigje me shkrim pse lejohet gërmimi në fjalë, ku si pasojë e këtij gërmimi është myllur njëra hyrje e saj.

**Shpëtim Zhegrovë**, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të PDK-së paraqiti këtë:

#### **D E K L A R A T Ë**

*Arrestimet e fundit, të bëra nga EULEX-i, janë të papranueshme dhe që cenojnë rëndë dhe padrejtësishët vlerat e larta morale dhe patriotike të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prandaj, Kuvendi Komunal në Vushtrri, shpreh indinjatë të thellë dhe njëkohësisht pakënaqësi me arrestimet dhe riarrestimet e vazhdueshme dhe të padrejta që po iu bëhen luftëtarëve të lirisë së Kosovës nga UNMIK-u, më parë dhe EULEX-i, tanë që nga përfundimi i luftës më 1999 e deri më sot.*

*Kuvendi komunal është i shqetësuar lidhur me akuzën e radhës të cilën e bëri EULEX-i ndaj ish-komandantëve dhe ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndaj atyre të cilët luftuan për lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës, të cilën po e gjëzojmë ne sot, ndaj atyre të cilëve kësaj toke i dhanë edhe anëtarët më të ngushtë ta familjes, ndaj atyre të cilëve me gjak e paguan këtë liri.*

*Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u vërtetua saktë se është e pastër edhe nga institucioni që ka përgjegjësi dhe ka mekanizma për të vërtetuar kriminelët e luftës, nga Tribunali i Hagës, ku nga ky tribunal u shpallën të pafajshëm Fatmir Limaj, Ramush Haradnaj, Lahi Ibrahimaj dhe Idriz Balaj.*

*Sikur Misioni i EULEX-it në Kosovë ka humbur qasjen objektive dhe ka kaluar në qasje subjektive, duke ngritur akuza të njëpasnjëshme ndaj komandantëve dhe*

*luftëtarëve të UÇK-së, dhe si duket këtë e bënë vetëm e vetëm për të "arsyetuar" misionin e vet në Kosovë. EULEX-i duhet të merret me burgosjen dhe dënimin e atyre që ua vranë anëtarët e familjes që tani po akuzohen padrejtësisht. Rasti më i keq është rasti i Fatmir Limajt, ku shihet qartë në bazë të deklaratave të dëshmitarëve, sesi janë sjellë prokurorët e EULEX-it, me arsyen që të krijojnë bazë për të ngritur aktakuza të pavërteta.*

*Ne kërkojmë nga EULEX-i që të mos e njollos luftën e pastër dhe të imponuar nga pushtuesit e Miloshevqit, luftën e lavdishme të UÇK-së dhe popullit të Kosovës, por të punojë në zbardhjen e krimineleve serbë, të cilët vranë, masakruan, torturuan popullin shqiptar. Të gjithë e dimë dhe kemi qenë dëshmitar se çfarë ka ndodhur në majin e vitit 1999, pikërisht në qytetin e Vushtrrisë, ku u masakruan qindra qytetarë civil dhe ku sot e atë ditë ende nuk dihet përfatim e disa prej tyre, thuhet në deklaratën e Kuvendit Komunal të Vushtrrisë.*

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i LDK-së shpreh shqetësimin që po akuzohen luftëtarët e lirisë, por gjithashtu dëshirojmë që drejtësia të mos interferohet nga politika dhe të vendoset sipas argumenteve.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se banorët e fshatit Novolan kanë paraqitur si brengë problemin e sigurisë, pasi që është paraqitur dukuria e vjedhjes së pasurisë së banorëve të fshatit në fjalë dhe është shqetësuese që deri më sot asnjë nga akterët që kanë kryer vjedhje nuk është zbuluar. Po ashtu banorët e fshatrave Novolan dhe Bruzniq kanë shtruar problemin e vendosjes së sinjaleve të komunikacionit në rrugën regionale që lidh Vushtrrinë me Skënderajn, pasi që në mungesë të shenjave të sinjalistikës, zhvillohet shpejtësi jashtëzakonisht e madhe, prandaj rreziku është shumë i madh edhe për banorët, dhe shtoi se qeveria komunale duhet ta ngrisë zërin në institucionet më të larta për t'u vendosur shenjat e komunikacionit. Në fund tha se është formuar një komision për emërimin e rrugëve nëpër fshatra, paraqiti vërejtje për shkak të numrit të madh të anëtarëve të këtij komisioni dhe në mesin e anëtarëve të komisionit ka njerëz që kanë nevojë të shkojnë në shkolla fillore për të mësuar alfabetin. Tutje tha se ka probleme të mëdha në terren, prandaj kërkoi nga qeveria lokale që të jetë e angazhuar sa më shumë, në mënyrë që të mos ketë konflikte ndërfamiljare në terren.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** lidhur me deklaratën e lexuar nga kryesuesi i Grupit kuvendar të PDK-së, tha se edhe Grupi kuvendar i AAK-së shpreh shqetësimin lidhur me ngjarjet e fundit, prandaj duke mos dashur të interferojmë në çështjen e drejtësisë, kërkojmë që drejtësia të jetë efektive, e paanshme dhe të bëjë trajtimin e barabartë për të gjithë qytetarët në Kosovë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë deklaratë, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanim vendosi me sa vijon:

Aprovohet deklarata në fjalë.

Në përfundim të diskutimeve rrëth rendit të ditës, kuvendi me vota unanim miratoi këtë:

#### REND DITE

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së;
2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 2014/01;

3. Shqyrtimi i Propozim –vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale për vendosjen e kiosqeve;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba komunale;
5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me standardet e ndërtimit të objekteve shumëkatëshe dhe pranimit teknik të tyre;
6. Shqyrtimi i Informatës mbi ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve pa leje ndërtimore, si dhe masat e ndërmarra për pranimet teknike të objekteve shumëkatëshe në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë;
8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme (shqyrtimi i dytë);
9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore të komunës;
10. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Gllavatin për kundërshtimin e vendimit të kuvendit të komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale Gllavatin;
11. Shqyrtimi i Propozim-listës për ndarje të mirënjojheve për nder të 17 Qershoret – Ditës së Çlirimt të Vushtrrisë;
12. Të ndryshme.

#### **1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit- në faqen nr. 2 të procesverbalit në fjalë kërkoi t'i përfshihet edhe kjo fjalë: "kryesuesi i kuvendit të komunës në ditën e parë pas aprovimit të rregullores së re është duke e shkelur rregulloren, dhe po ashtu është duke i prirë shkeljes së rregullores".**

**Aprovohet unanimisht procesverbali në fjalë, me vërejtjen dhe sugjerimin e B.Jasharit.**

#### **2. Shqyrtimi i Qarkores Buxhetore 2014/01.**

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- paraqiti sqarime hyrëse lidhur me Qarkoren Buxhetore 2014/01.**

**Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar qarkores buxhetore në fjalë, tha se qarkorja duhet të qarkullojë dhe të modifikohet sa i përket shpërndarjes së mjeteve dhe shpenzimit të tyre, dhe shtoi se është e rëndësishme që të respektohen afatet buxhetore për hartimin e strategjisë së projekteve për shpenzimin e mjeteve që rezulton me dëgjime dhe propozime buxhetore sipas programeve që janë të parapara dhe sipas afateve, pra duhet të respektohen hapat e procesit buxhetor siç janë: Themelimi i kornizës afatmesme, caktimi i prioriteteve, caktimi i kufijve fillestar dhe specifik, dorëzimi i propozimit buxhetor komunal, dëgjimet buxhetore, përgatitja e dokumentacionit buxhetor, shqyrtimi i buxhetit nga kuvendi dhe aprovimi përfundimtar i buxhetit. Në vazhdim tha se rritja e granteve ka ndikuar për arsy se në këtë qarkore buxhetore janë disa risi buxhetore, prandaj këto risi buxhetore kanë ndikuar që grante, siç është granti për arsim dhe shëndetësi të ketë rritje krahasuar me vitin 2013, por për vitet 2014, 2015 dhe 2016 shihet se granti për arsim dhe për shëndetësi (përkundër nevojave të mëdha) ka një rritje simbolike. Kurse lidhur me projekcionin, tha se qeveria lokale duhet të ketë një angazhim më të madh në vitet 2014-2016 te projekzionet e të hyrave vetanake, në mënyrë që të mundësohet plotësimi i nevojave të qytetarëve. Në fund duke iu referuar tabelarit në**

faqe nr. 22, tha se kjo tregon që drejtoritë komunale duhet të punojnë shumë në përcaktimin e misionit, vizionit dhe qëllimit, si hapa kyç, të cilët do të shërbejnë për buxhetimin e programeve, nevojave të tyre në mënyrë sa më kualitative, pra edhe planifikimi dhe shpenzimi i mjeteve të jenë të balancuara, duke iu përshtat programeve dhe nevojave të qytetarëve.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** në emër të Grupit kuvendar të LDK-së kërkoi që të respektohen procedurat dhe afatet.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar qarkores buxhetore në fjalë, tha se ka një rritje të theksuar të buxhetit në Sektorin e arsimit, por është e pamjaftueshme, prandaj qeveria komunale gjatë realizimit të takimeve në nivel qendror duhet të kërkojë që për secilin zë buxhetor të ketë rritje buxhetore, sepse as numri i banorëve i paraqitur për Vushtrri nuk është real, sepse numri real i banorëve është më i madh.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar qarkores buxhetore në fjalë, tha se ndarja e buxhetit është bërë konform ligjit.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se pajtohet që vërejtjet dhe sugjerimet që paraqiten gjatë diskutimit publik të vijnë në kuvendin e komunës me kohë dhe në afate dhe pastaj të adresohen në organet kompetente, me ç'rast shtoi se anëtarët e kuvendit nuk e kanë rolin vetëm të pajtohen, duke shtuar se propozimet dhe sugjerimet që do të jepen, do ta pasurojnë këtë qarkore buxhetore.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se qarkorja buxhetore në fjalë është definitive dhe asnjë komunë nuk mund të ndërhyjë në të për ta ndryshuar.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar shumës së caktuar për të hyrat vetanake për Komunën e Vushtrrisë, tha se nëse kemi argumente se një shumë e tillë nuk është caktuar drejt, atëherë mund të ndikojmë në Ministrinë e Financave.

### **3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale për vendosjen e kiosqeve.**

**Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se jemi duke bërë përpjekje që kiosket të vendosen aty ku ka mundësi dhe sipas standardeve profesionale që i përcakton komisioni i formuar nga kuvendi i komunës.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i LDK-së e mbështet propozim-vendimin në fjalë, por kërkoi që të shtohet një paragraf i ri me këtë përbajtje: "pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe tri lokacionet e përcaktuara në skicë nga organi kompetent".

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** paraqiti vërejtje që në një faqe të materialit të propozim-vendimit në fjalë nuk duket përbajtja e tij në mënyrë të qartë, prandaj kërkoi që në ardhmen të mos përsëritet një gjë e tillë. Pastaj tha se do të ishte mirë që në rastet kur merren vendime të tillë që prekin interesin e komunitetit të biznesit, të bisedohet me ta, të informohen, si dhe t'i sqarohet se cili është qëllimi i nxjerrjes së këtij vendimi.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, përmendi një rast ku një person e mban familjen e tij përmes të ardhurave që realizon nga një kiosk, prandaj komuna duhet ta ketë parasysh faktin se nga këto kiosqe sigurojnë të ardhurat përfamiljet e tyre, përderisa komuna nuk ka mundësi që atyre t'i bëjë zgjidhje përfundim.

**Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit-** tha se edhe në KPF e ka përkrahur propozim-vendimin në fjalë me të vetmen vërejtje që tek stacioni i autobusëve të mos ketë kiosqe, pasi që aty janë bërë disa investime, por dhe është krijuar një kaos nga autobusët dhe restorantet, prandaj nëse vendosen kiosket do të bëhet një çrrëgullim më i madh. Në fund pyeti se a ka bërë drejtoria komunale në fjalë ndonjë specifikim

të kostos së këtyre objekteve që do të ndërtohen, si dhe a ka mundësi që komuna të merr përsipër ndërtimin e këtyre objekteve, pasi që do të ndërtohen sipas specifikave të përcaktuara nga komuna dhe çka do të ofrojë (cilat shërbime) komuna në rast të ndërtimit të këtyre objekteve.

**Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së-** sqaroi se komuna nuk ka paraparë buxhet për ndërtimin e kiosqe apo të infrastrukturës tjeter, por pala e interesuar e merr vetëm parcelën, ndërsa kriteret tjera caktohen nga drejtoria përkatëse.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se çdo kontratë kur lidhet me rastin e dhënes së hapësirave në shfrytëzim nga komuna bëhet në baza ligjore pas zbatimit të të gjitha procedurave të parapara me norma juridike (ligje, rregullore).

**Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit-** tha se e mbështet propozim-vendimin në fjalë dhe propozoi që për këto kiosqe të ketë një kriter edhe sa i përket gjerësisë dhe gjatësisë së tyre, të kenë të njëjtën madhësi, të njëjtën ngjyrë.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** propozoi që këto kiosqe t'i jepen atyre njerëzve që kanë nevojë, pasi që nga praktika e deritanishme ka pasur raste që i jepet një personi, i cili ia jep kioskën me qira tjetrit, prandaj kërkoi që një gjë e tillë të mos ndodh.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim lejohet dhënia në shfrytëzim afatshkurtër e pronës së paluajtshme të Komunës së Vushtrrisë, të cilat gjenden në këto lokacione:

Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Gjon Buzuku" certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-70202016-00045, Zona kadastrale Vushtrri pronë e Komunës.

Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Kruja" certifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. UL-70202016-01534, Zona kadastrale Vushtrri pronë e Komunës.

Lokacioni i cili gjendet në rrugën "Hamit Hyseni" me numër të P-4865/1 Fletëtreguesi nr.924, Zona kadastrale Vushtrri pronë e Komunës.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë edhe tri lokacionet e përcaktuara nga organi kompetent.

Pronat e cekura si në nenin 1 të këtij vendimi epen në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandeve personave fizik dhe juridik, në kohëzgjatje prej 3 viteve me mundësi vazhdimi të.

#### **4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba Komunale.**

**Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së-** paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Ismet Gashi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar propozim-vendimit në fjalë, kërkoi sqarim pse të hiqet nen 22 nga rregullorja. Po ashtu kërkoi sqarim pse nuk është paraparë heqja e nenit 29.

**Idriz Ismajli, drejtor i DUMM-së-** tha se nen 22 duhet të hiqet, sepse duhet të ketë një konkurrencë në mes të të interesuarve. Po ashtu kërkoi që të hiqet edhe nen 29.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

**Me këtë vendim, ndryshohet dhe plotësohet Rregullorja për Tarifa Ngarkesa dhe Gjoba Komunale 01nr.330/12, dt.27.12.2012, si vijon:**

**Hiqen nenet: 10, 11, 12, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20.2, 20.3, 22, 23, 24 dhe 26.1.4.**

**Paragrafëve 25.1 dhe 25.2 të nenit 25, në fund të tekstit, iu shtohen fjalët: "për objektet për të cilat nuk kërkohet leja e ndërtimit".**

**Neni 14 riformulohet sipas tekstit në vijim: Për shndërrimin e objekteve banesore në objekte afariste aplikohet taksë e njëjtë administrative e cila aplikohet për lëshimin e lejeve të ndërtimit.**

**Nenit 25.5.3 i shtohen fjalët: "për vit".**

**Pas nenit 30, shtohen tri nene të reja si në vijim:**

**Për lëshuarje të lejes së ndërtimit paguhet taksë administrative prej 2.54 € për m<sup>2</sup>. Me rastin e llogaritjes së lartësisë së taksës për leje ndërtimore për objekte të banimit, aplikuesi do të paguaj në të njëjtën kohë edhe tarifën rregullative për rrjetjen e densitetit të infrastrukturës në shumë prej 2.52 € për m<sup>2</sup> për hapësira të banimit**

**Për lëshuarje të lejes për rrënim të objekteve ndërtimore aplikohet taksë komunale fikse prej 15 € (pesëmbëdhjetë euro).**

## **5. Shqyrtimi i Informatës lidhur me standardet e ndërtimit të objekteve shumëkatëshe dhe pranimit teknik të tyre.**

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit-** tha se në informatën në fjalë nuk është paraqitur asnjë ndërtim i këtij viti. Pastaj tha se duhet të dihet se në këto sipërfaqe leja dhe ndërtimi fizik në terren, a përputhen mes vete, a janë paguar në përgjithësi taksat, dhe shtoi se informata në fjalë nuk është e kompletuar, prandaj kërkoi që të kompletohet kjo informatë ku duhet të flitet rrëth standardit, kualitetit, sipërfaqeve dhe obligimeve të kryera nga pronarët e këtyre objekteve.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** paraqiti vërejtje që informata në fjalë nuk ka ardhur në kuvendin e komunës përmes kryetarit të komunës. Pastaj tha se në informatë do të duhej të cekej se për cilën periudhë kohore paraqitet kjo informatë. Në vazhdim duke u lidhur me faqen nr. 3 të kësaj informate, tha se ka objekte që nuk kanë leje të përdorimit, por janë në përdorim, por ka të tjera që nuk kanë leje të përdorimit, por ende nuk janë në përdorim. Mirëpo ka objekte ndërtimore që janë në përdorim dhe nuk paskan leje përdorimi, prandaj nëse ligji nuk zbatohet dhe nuk merren masa, atëherë pse ekzistojnë institucionet, dhe shtoi se kryetari i komunës dhe drejtori i drejtorisë përkatëse duhet me qenë pionier të zbatimit të ligjit, kurse kuvendi i komunës duhet t'i qëndrojë prapa.

**Idriz Ismajli, drejtor i DUMIM-së-** sa i përket formës së informatës, tha se është konsultuar me juristët dhe ata kanë thënë që informata nuk ka nevojë të procedohet në kuvend përmes kryetarit. Kurse informata është paraqitur ashtu siç është e parashikuar në Planin vjetor të punës së kuvendit të komunës.

## **6. Shqyrtimi i Informatës mbi ndërtimet dhe parandalimet e ndërtimeve pa leje ndërtimore, si dhe masat e ndërmarra për pranimet teknike të objekteve shumëkatëshe në Komunën e Vushtrrisë.**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar informatës në fjalë, tha se në informatë nuk është cekur se për cilën periudhë bëhet fjalë. Pastaj tha se drejtori i Drejtorisë për Inspektimë do të duhej ta shikonte (përmes inspektorëve kompetent) sesi po rrjedhin këto punime në rr. "Dëshmorët e Kombit", pasi që është rruga kryesore nga e cila varet shumë frekuentimi i qytetarëve, dhe shtoi se kompania që është duke i kryer punimet në këtë rrugë do të duhej të vendoste tabelën e cila do të tregonte se kur fillojnë këto punime dhe kur pritet të përfundojnë, prandaj është detyrë e inspeksionit që të inspektojë edhe punimet në Sektorin publik. Mandej lidhur me tabelën e paraqitur në informatë, tha se do të duhej të paraqitej edhe

arsyetimi pse janë ndërprerë punimet për secilin objekt. Në fund kërkoj që informata në fjalë të plotësohet edhe me të dhëna tjera shtesë, siç i përmendi më lartë.

## **7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Komunën e Vushtrrisë.**

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** lidhur me informatën në fjalë, tha se jemi dëshmitarë se në vitet që po i lëmë, ka pas zjarre që kanë sjellë shumë dëme, ku kanë shkretuar sipërfaqe të tëra me drunj (me qindra hektarë), dhe siç shihet edhe nga informata në fjalë akoma nuk është kompensuar ky dëm dhe nuk janë pyllëzuar ato sipërfaqe të pyjeve që janë djegur, me ç'rast shtoi se nga informatat që ka marrë prej mediave, thuhet se në këto vite janë dëmtuar (djegur) mbi 270 hektarë pyje në Komunën e Vushtrrisë, prandaj kjo është shumë brengosëse. Në vazhdim duke iu referuar paragrafit të dytë të informatës në fjalë, propozoi që pylltarët të pajisen me kuaj, në mënyrë që më me sukses t'i mbrojnë pyjet, pasi që ka zona të thella që nuk mund të hyhet as me makinë dhe as me motor. Mandej duke iu referuar paragrafit të katërt të informatës në fjalë, që flet për planin e pyllëzimit, pyeti se prej cilës datë ka filluar.

**Nasuf Aliu, drejtor i DEBPZHR-së-** duke iu referuar informatës në fjalë, tha se problemi i pyjeve është në të gjithë Kosovën e jo vetëm në Vushtrri. Pastaj tha se Sektori i pylltarisë ka qenë një sektor shumë i shkatërruar, totalisht i paorganizuar dhe problemet kanë qenë të ndryshme. Në vazhdim tha se drejtoria përkatëse çdo vit harton plan për sipërfaqe të reja pyllëzimi dhe për ripyllëzime. Ndërsa lidhur me propozimin për pajisje të pylltarëve me kuaj, tha se është problem menaxhimi i tyre. Në vazhdim paraqiti sqarime hyrëse lidhur me informatën në fjalë.

**Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit-** tha se sa i përket menaxhimit të pylltarisë është shumë lehtë të realizohet, pasi që janë pesë pika të caktuara që konsiderohen hyrje, dhe shtoi se në komunën tonë nuk ka pyje, sepse janë shkatërruar totalisht.

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** tha se e mbështet informatën në fjalë, pasi që pyjet konsiderohen një pronë e rëndësishme kombëtare. Pastaj tha se nuk konsiderohet e lehtë të menaxhohet mbrojtja e pyjeve, dhe kërkoj që të bëhen përpjekje maksimale që të mbrohen pyjet.

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** pasi që e mbështeti informatën në fjalë, pyeti se si qëndron puna me pishat në Komunën e Vushtrrisë, pasi që pisha është një prej pastriesve më të mirë të ambientit dhe për njeriun paraqet një filter në mushkëri.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** lidhur me informatën në fjalë, tha se përderisa kompetenca për mbrojtjen e pyjeve ishte e nivelit qendror, situata ka qenë kaos, kurse tanë prej që kompetenca është bartur në nivelin lokal, situata është marrë nën kontroll. Pastaj tha se mos-hartimi i Rregullores për mbrojtjen nga zjarri (që ka qenë e planifikuar me Planin vjetor të punës së kuvendit) është si rezultat i marrjes së kompetencave nga niveli qendror.

**Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit-** tha se këto nuk quhen pyje, por quhen shkurre, sepse nuk ka pyje në komunën tonë, pasi që pyjet janë masa drusore, nga e cila përfiton ekonomia kommunale. Pastaj tha se është mirë të dihet se edhe sa punëtorë i duhen këtij dikasteri për të pasur mundësi mbrojtjen e pyjeve ashtu siç duhet, prandaj është mirë të hartohet një strategji për këtë qëllim. Në vazhdim duke iu referuar njërsë prej sfidave e që janë përmendur temperaturat e larta, tha se ne nuk jetojmë në Afrikë që nga temperaturat të digjen pyjet, dhe shtoi se faktori njeri po i shkakton zjarret.

**Nasuf Aliu, drejtor i DEBPZHR-së-** tha se nuk pajtohet me vlerësimin se në komunën tonë nuk ka pyje, pasi që e vërteta është se edhe në komunën tonë ka pyje. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me informatën në fjalë.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** duke iu referuar informatës në fjalë, tha se decentralizimi në këtë segment nuk është bërë i plotë, sepse po të bëhej i plotë do të ishte gjendja më e mirë, pasi që kanë bartur përgjegjësitë vetëm për kontrollimin dhe parandalimin e dëmtimit të pyjeve. Pastaj tha se pengesë tjetër është edhe joazhuritë i gjykatës. Mandej njoftoi se ka filluar një bashkëpunim edhe më i mirë me policinë, dhe kjo krijon mundësinë për mbrojtje edhe më të mirë të pyjeve. Në fund tha se në shumicën e rasteve faktori njeri shkakton djegien e pyjeve.

#### **8. Shqyrtimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme (shqyrtimi i dytë).**

**Qazim Azemi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, paraqiti këto propozime: te nen 1, propozoi t'i shtohet "dhe nxënësve", po ashtu propozoi që fjala "nxënës" t'i shtohet edhe emërtimit të kësaj rregulloreje; te nen 2, propozoi të shtohet një aline e re me këtë përmrbajtje: "bursa mund të marrin edhe nxënësit e talentuar të shkollave të mesme të ulëta dhe shkollave të mesme të larta". Po ashtu te nen 2, propozoi aline të re, me këtë përmrbajtje: "studentët dhe nxënësit bursistë që i kryejnë me sukses studimet apo klasat, iu vazhdohet kontrata deri në mbarim të studimeve, respektivisht shkollimit".

**Ferit Idrizi, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, tha se këtij drafti i mungojnë shumica e elementeve dhe si i tillë nuk i plotëson as për së afërmë dispozitat e një rregulloreje për t'u aprovuar në kuvend, prandaj propozoi që të shtyhet për mbledhjen e ardhshme, për këto arsy: Ideja nuk është e strukturuar mirë, sepse është dashtë të strukturohet se çka po dëshirojmë; sigurimin e fondeve, cilat kategori, a janë bursa apo ndihma, nëse janë bursa që i fusin në konkurrencë studentët e shkëlqyer, atëherë duhet të ketë kritere për to e nëse janë ndihma që i fusin kategoritë e ndryshme, atëherë duhet të shkojnë jashtë këtyre kriterieve, nëse flitet për fëmijët e dëshmorëve, atëherë duhet të dihet se kush bën pjesë në familje, pastaj duhet të precizohen cilat janë drejtimet deficitare. Po ashtu kërkoi që të mos diskriminohen studentët e universiteteve private dhe mandej duke iu referuar nenit 2, tha se kuvendi nuk ndan bursa, por kuvendi e aprovon buxhetin.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, së pari paraqiti vërejtje për kryetarin e komunës që e ka lejuar që të mungojë drejtori i Drejtorisë për Arsim, në kohën kur po debatohet për këtë draft-rregullore. Pastaj lidhur me nenin 6.1, pyeti se a do të ishte më mirë të plotësohej me këtë fjali: "ose nëse është në marrëdhënie pune në institucion publike", sepse nëse merr pagë nga institucionet publike (nga Buxheti i Republikës së Kosovës) të mos merr edhe bursë. Te nen 8 nën "e", kërkoi që çështja e kriterit të analizohet mirë dhe me trajtim të duhur, pasi që një student mund ta ketë notën mesatare 7.5 ose 8 dhe vjen nga një fshat i thellë, dhe i njëjti nuk ka mundur të sigurojë konvikt, prandaj nuk mund të trajtohet njëjtë me atë që i ka kushtet shumë më të mira. Te nen 12 nën "b", pyeti sesi duket dhe kush e jep deklaratën e bashkësisë familjare, kurse për të njëtin nen, nën "c" te fjalia "me gjendje ekonomike sociale" propozoi t'i shtohet fjala "të rëndë".

**Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit-** lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se edhe në KPF jemi marr vesh që bursat të ndahen për studentë dhe nxënës. Kurse lartësia e bursës për studentë dhe nxënës të jetë e ndryshme, sepse studenti ka shpenzime më shumë, kurse nxënësi më pak, prandaj korelacioni të jetë 70 me 30.

**Hashim Hajrizi, zyrtar nga Drejtoria për Arsim-** paraqiti sqarime shtesë lidhur me draft-rregulloren në fjalë.

**Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit-** lidhur me draft-rregulloren në fjalë, tha se kuvendi i komunës ndan bursa me vendim. Pastaj tha se nota mesatare duhet të jetë 8.5 pa marrë parasysh nga vjen dhe ku jeton studenti. Po ashtu tek kriteret për aplikim, tha

se duhet të kenë të drejtë aplikimi për bursa vetëm studentët e universiteteve publike, sepse dihet se çka po ndodh me universitetet private.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës**- duke iu referuar draft-rregullores në fjalë, propozoi që bursa të ndahen vetëm për studentët, kurse për nxënësit e shkollave të mesme të ndahen shpërblime. Në fund propozoi që aprovimi i kësaj draft-rregulloreje të shtyhet për mbledhjen e radhës së KK-së.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Që të shtyhet për mbledhjen tjetër të KK-së aprovimi i Draft-rregullores për ndarjen e bursave për studentë dhe nxënës të shkollave të mesme.

#### 9. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ridestinimin e mjeteve të lira buxhetore të komunës.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit**- lidhur me propozim-vendimin në fjalë, pyeti sesi ka ardhur deri te këto mjete të lira. Po ashtu te rasti i mbi 8.763 € që janë menduar të shkojnë për pajisje laboratorike, pyeti se a nuk ka qenë me kohë planifikimi i mirë, si dhe a është kryer gëlqerosja dhe rregullimi i toaleteve në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare siç ka qenë e paraparë. Mandej kërkoi që të sqarohet domethënia e shkurtesës AMV. Në fund tha se nëse mendohet që të ridestinohen 700 € në rrugën e Dolakut- te ferma dhe 1.000 € diku tjetër, pyeti se a për këtë shumë ka mbetur projekti keq për t'u rregulluar siç duhet, ndërkaq shtoi se ka dyshime që ndonjëherë po bëhen ridestinime të mjeteve sa për të treguar para publikut se po kryhen projekte, ndërsa përmendi rrugën në Bukosh e cila ka filluar të dëmtohet, për shkak të cilësisë së dobët të punimeve.

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së**- sqaroi se për projektin e parë është nënshkruar kontrata, por nga ky projekt kanë tepruar mjete në vlerë prej 2.700 €, kurse këto mjete janë paraparë të ridestinohen për projektet që janë para fazës së nënshkrimit të kontratës. Kurse lidhur me fondin 22, tha se Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, ka bërë paramasën dhe parallogarinë për rregullimin e tualeteve dhe gëlqerosjen, por nga realizimi i projektit kanë tepruar mjete dhe me kërkesën e të njëjtës drejtori është kërkuar që këto mjete të ridestinohen për pajisje mjekësore për laborator.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ridestinohen mjete nga fondi 10, nga kategoria e investimeve kapitale (programi 66425, Planifikimi Urban dhe Mjedis), kodi i projektit 88543, asfaltimi i rrugëve lokale në fshatin Maxhunaj në vlerë 30,000.00 €, dhe nga ky projekt shuma e mjeteve të lira buxhetore 2,797.00 € ridestinohen si vijon:

- Asfaltimi i rrugës lokale Dolak - te Ferma, kodi (88522)..... 700.00€;
- Asfaltimi i rrugëve Novolan - lagja Zhabari, kodi (88521) ..... 1,011.00€;
- Asfaltimi i rrugëve lokale Bruznik, kodi (88517) ..... 1,086.00€.

Nga fondi 22, të hyrat e bartura në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, (kodi i programit 74450) nga projekti (kodi i projektit 86193) "Rregullimi i tualeteve dhe gëlqerosja e QMF-ve dhe AMV" në shumën prej 17,000.00 €, nga ky projekt shuma e mjeteve të lira 8,763.90€ ridestinohet në projektin e ri:

- Pajisjet mjekësore për laborator ..... 8,763.90€.

**10. Shqyrtimi i peticionit të banorëve të fshatit Gllavatin për kundërshtimin e vendimit të kuvendit të komunës pér dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në Zonën Kadastrale Gllavatin.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** duke iu referuar peticionit në fjalë, në emër të Grupit kuvendar të PDK-së kërkoi që kontrata të mos vazhdohet dhe e njëjta të përfundojë në muajin shtator, kurse parcela në fjalë t'i ujejet prapë në shfrytëzim banorëve të fshatit.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** lidhur me peticionin në fjalë, tha se propozimi i shefit të Grupit kuvendar të PDK-së është shumë i qëlluar.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

**Kuvendi i Komunës konsideron të arsyeshëm shqetësimet e banorëve të fshatit Gllavatin.**

**Kuvendi i Komunës e obligon drejtoren kompetente që pas skadimit të kontratës pér shfrytëzimin e parcelës në fjalë, të mos i vazhdon kontratën pér shfrytëzim të mëtutjeshëm z. Raif Durakut nga fshati Stroc, por parcela në fjalë t'i mbetet në shfrytëzim banorëve të fshatit Gllavatin.**

**11. Shqyrtimi i Propozim-listës pér ndarje të mirënjohjeve pér ndër të 17 Qershorit – Ditës së Çlirimt të Vushtrrisë.**

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** tha se Grupi kuvendar i LDK-së ka qëndrim se pasi që materiali me propozimet ka ardhur me vonesë dhe pasi që nuk na është krijuar mundësi që të përgatisim propozime të qëlluara, si dhe të vlerësojmë këto propozime, nuk do të marrim pjesë në vendim.

**Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit-** tha se nuk pajtohet me propozimet që janë paraqitur pér këto biznese, kur dihet se ka shumë biznese tjera më të suksesshme se këto dhe shtoi se Emona Center i ka 200 të punësuar.

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit-** tha se në bazë të rregullores i njëjti person fizik ose juridik nuk ka të drejtë të merr dy herë mirënjohje dhe shtoi se edhe kompanitë që janë propozuar pér mirënjohje kanë numër të konsideruar të punëtorëve dhe janë mjaft të suksesshme, dhe të njëjtat janë kompani me renome rajonale.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit-** pér mirënjohje propozoi Halim Feratin (post mortum) i cili ka qenë bashkëluftëtar i Ahmet Selacit dhe Ukshin Kovaçicës, si dhe i burgosur në vitin 1947, kurse propozimi tjetër pér Tafil Mërnicën (post mortum), i cili ka qenë veprimtar i çështjes kombëtare në diasporë, si dhe humanist i madh.

**Ergin Sunguri, anëtar i kuvendit-** propozoi t'i ndahet mirënjohje Komunës së Mamakut.

**Sabri Ferati, anëtar i kuvendit-** propozoi pér mirënjohje Rrahim Tahirin, veteran i UÇK-së. Po ashtu propozoi pér mirënjohje Florent Hasanin, futbollist i dalluar.

**Habib Mustafa, kryesues i kuvendit-** propozoi pér mirënjohje Faruk Sungurin, pér kontributin e dhënë pér kulturë.

**Haki Maloku, përgjegjës i sekretarisë-** tha se në ditën e çlirimt do të ketë mysafirë nga dy komuna të Turqisë dhe nga dy komuna të Shqipërisë, prandaj propozoi që t'i u ndahet mirënjohje përfaqësuesve të këtyre katër komunave.

**Gjylsime Feka, anëtare e kuvendit-** propozoi që të reduktohet numri i propozimeve pér mirënjohje nga shoqata e martirëve të lirisë dhe nga shoqata e invalidëve të luftës, si dhe nga bizneset. Po ashtu propozoi që të ndahet mirënjohje vetëm pér një drejtor të shkollës, duke i pasqyruar edhe rezultatet e asaj shkolle.

**Islam Krasniqi, anëtar i kuvendit- propozoi që t'i ndahet mirënjohje haxhi Feriz Zekollit, i cili ka kontribuuar në pajtimin e gjaqeve, si dhe familja e tij ka kontribuuar shumë për luftën e UÇK-së.**  
**Hajrulla Muli, anëtar i kuvendit- propozoi për mirënjohje Milot Rashicën, futbollist i dalluar.**

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:  
**Me këtë vendim për nder të Ditàs së Çlirimt të Vushtrrisë, më 17 qershor 2013, nderohen me mirënjohje siç vijon:**

- 1. Behar Mehdi Haziri, bir i Dëshmorit, student i dalluar;**
- 2. Besarta Enver Musa, bijë e Dëshmorit nxënëse e dalluar;**
- 3. Kaltrina Avni Saraçi, bijë e Dëshmorit nxënëse e dalluar;**
- 4. Sadik Halili, i plagosur në Prekaz tek familja Jashari, në luftën kundër forcave pushtuese serbe, për sakrificë në çlirimin e vendit;**
- 5. Sheshivar Shala, invalid i luftës së UÇK-së - për kontribut të dhënë gjatë luftës në Kosovë;**
- 6. Brahim Gérxhaliu anëtar i familjes martire – për martirizim të anëtarit të familjes gjatë luftës në Kosovë;**
- 7. Vildane Mulaku kryefamiljare e familjes martire – për martirizim të anëtarit të familjes gjatë luftës në Kosovë;**
- 8. Hatixhe Gérxhaliu anëtar e familjes martirë – për martirizim të anëtarëve të familjes gjatë luftës në Kosovë;**
- 9. Muhamet Aliu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;**
- 10. Sheremet Saraçi, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;**
- 11. Osman Musliu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;**
- 12. Salih Salihu, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;**
- 13. Behxhet Jashari, veteran i luftës së UÇK-së, për kontributin e dhënë gjatë luftës në Zonën Operative të Shalës;**
- 13. Rexhep Mehmeti, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;**
- 14. Ilmi Muzaqi, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;**
- 15. Naser Tahiri, i burgosur politik, për kontributin e dhënë për çështjen kombëtare;**
- 16. Filip Gjonci, drejtëor i Arsimit Durrës - për bashkëpunim të suksesshëm me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, në ngritjen dhe forcimin e procesit mësimor-edukativ;**
- 17. Kastriot Kodheli, drejtëor i Arsimit Lezhë - për bashkëpunim të suksesshëm me Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Vushtrrisë, në harmonizimin e punës së planeve zhvillimore në shkolla;**
- 18. Devim Yoruk, drejtëor i Kolegjit “Mehmet Akif” Banullë – Lipjan për bashkëpunim të suskessëshëm dhe ndihmë në fushën e vlerësimit të nxënësve;**

- 19. USAID/DEMI - Iniciativa për komuna efektive demokratike, - për mbështetje të komunës në projekte të shumta si dhe përkrahje në ngritjen e performancës komunale;**
- 20. Sahit Parduzi, Drejtor i SHMU - II, - për rezultate në punë në SHMU - II në Vushtrri;**
- 21. Isak Bajrami (post mortum), ish drejtor i SHMU "A.Z. Çajupi" – Vushtrri, për menaxhim të suksesshëm edukativo-arsimor dhe sportiv në Komunën e Vushtrrisë;**
- 22. Dr. Isak Berisha, kirurg, Spitali "Sheik Zayed"- Vushtrri, për kontributin e dhënë në fushën e shëndetësisë;**
- 23. Bekim Selmani, për rezultate në punë në administratën e komunës;**
- 24. Agim Munishi, koreograf i Ansamblit të këngëve dhe valleve "Hasan Prishtina" në Vushtrri, për rezultate të shumta në koncerте dhe festivalë të nivel vendi dhe ndërkombëtar;**
- 25. Vedat Hyseni, Ashlan - bujk i dalluar në Komunën e Vushtrrisë;**
- 26. Baki Haradinaj, Stanoc i Epërm - fermer i dalluar në blegtori në Komunën e Vushtrrisë;**
- 27. Muhamet Sfarqa, Studime e Poshtme - bletar i dalluar në Komunën e Vushtrrisë;**
- 28. Kompania "Ariani" Vushtrri, për biznes të suksesshëm dhe punësim në veprimtarinë biznesore;**
- 29. NPT "Preteni", biznesmen i suksesshëm në prodhimin e dyerve dhe dritareve;**
- 30. Kompania "Albed" Vushtrri, për biznes të suksesshëm;**
- 31. Halim Ferati (post mortum), ish i burgosur politik;**
- 32. Tafil Mërnica (post mortum), veprimtar i çështjes kombëtare;**
- 33. Komuna Mamak (Turqi), për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 34. Komuna Saruhanli (Turqi), për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 35. Rrahim Tahiri, veteran i UÇK-së, për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së;**
- 36. Faruk Sunguri, për kontributin e dhënë në zhvillimin e jetës kulturore;**
- 37. Feriz Zekollı, për kontributin e dhënë në pajtimin e gjaqeve;**
- 38. Milot Rashica, futbollist i dalluar;**
- 39. Bashkia e Fierit, për bashkëpunim të suksesshëm dhe avancim të qeverisjes lokale;**
- 40. Florent Hasani, sportist i dalluar.**

## **12. Të ndryshme.**

**Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- pasi që anëtarët e këtij kuvendi u pajisëm me laptop, shtoi se në vendim të kuvendit thuhet që me laptop duhet të pajisen edhe dy zyrtarët e sekretarisë, prandaj kërkoi që edhe dy zyrtarët e sekretarisë të pajisen me laptop.**

**Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se vitin e kaluar ka qenë një projekt i planifikuar për rregullimin e rrugës që lidh fshatin Begaj me rrugën që shkon për Gojbulë, por nuk është realizuar për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore dhe i njëjtë është bart për vitin 2013, prandaj pyeti pse akoma nuk kanë filluar punimet, përderisa po shtrohen disa rrugë tjera, që nuk kanë qenë fare të planifikuara.**

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se është e vërtetë që ka qenë e planifikuar rruga e përmendur nga anëtari i kuvendit V.Karaça, por jemi duke bërë përpjekje që asnjë rrugë në kubëza apo në asfalt të mos shtrohet, pa u zhvilluar infrastruktura nëntokësore, kurse për rrugën në fjalë është bërë paramasa, janë ndarë mjetet dhe kanë dashur ta shtrojnë pa e zhvilluar infrastrukturën nëntokësore të ujësjellësit dhe të kanalizimit, por një gjë të tillë nuk e ka lejuar.

**Refik Ramaj, anëtar i kuvendit-** e paraqiti kërkesën e banorëve të fshatit Nadakoc, pasi që po iu nevojitet me urgjencë që të rrënohen shkolla e vjetër, sepse nëse nuk bëhet shpejt rrënim, po e humbin një donacion për ndërtimin e një fushe sportive, prandaj kërkoi që nëse ka mundësi të përshtapjetohen procedurat.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se e ka marrë edhe kërkesën me shkrim prej banorëve të fshatit Nadakoc, por nuk mund të biem pre e secilës kërkesë se si dhe kur të veprohet. Por nëse ata e kanë siguruar donacionin, le të vijnë në komunë për të garantuar se e kanë siguruar donacionin dhe menjëherë e fusim në procedurë atë donacion për ta rregulluar fushën e sportit dhe e rrënojmë objektin e shkollës së vjetër.

**Besim Jashari, anëtar i kuvendit-** e mbështeti atë që e tha përfaqësuesi i Grupit kuvendar të PDK-së për çështjen e zbatimit të vendimit për pajisjen me laptop për të gjithë sipas vendimit të kuvendit të komunës. Pastaj tha se ka raste që po shtrohen shumë rrugë me kubëza, por ka edhe rrugë që shumë kanë kontribuar për këtë shoqëri dhe është mirë që edhe ne si përfaqësues të zgjedhur të kësaj shoqërie t'ju japid përkrahje duke ua njojur kontributin e tyre, dhe shtoi se janë disa rrugë si: "Vëllezërit Frashëri", "Shaban Kapuç'i", "Hajzer Jashari". Mandej tha se lagjja e "Starasellëve" nga Dumnica e Llugës i ka drejtuar kërkesë kryetarit të komunës për rregullimin e rrugës së tyre, prandaj kërkoi që të merret në konsideratë kërkesa e tyre. Në fund kërkoi informatë se a janë tejkaluar problemet lidhur me ndërtimin e objektit të ri të komunës.

**Bajram Mulaku, kryetar i komunës-** tha se për shtrimin e rrugëve në kubëza nëpër lagje kërkohet edhe participimi i qytetarëve, kurse lagjja "Vëllezërit Frashëri" ka filluar ta bëjë grumbullimin e mjeteve, por një banor ka akuzuar se qëllimi i grumbullimit të mjeteve është për t'i keqpërdorur dhe prandaj ka dështuar grumbullimi i mjeteve, ndërsa në lagjen e "mulla Feratit" propozoi që të lironen nga participimi dhe e njëjta të shtrohet me kubëza. Ndërsa për lagjen e "Starasellëve", tha se nuk po ka mundësi të gjitha rrugët të shtrohen menjëherë dhe shtrimi i rrugëve po bëhet me prioritet për ato vende ku ka më shumë banorë. Në fund lidhur me ndërtimin e objektit të ri të komunës, tha se komuna nuk e ka proceduar tenderin, por është ne menaxhim të Komisionit Evropian dhe i njëjti ka probleme me kompaninë që ka fituar tenderin për ndërtimin e objektit.

Mbledhja përfundoi në orën 15:55.

Procesmbajtësi

Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit

Habib Mustafa

Lekturoi:

Vlora Krasniqi